

Kushtet dhe kriteret e tjera të botimit

1. Revista është e përkushtuar që t'i përmbahet parimeve shkencore për botim. Prandaj bashkë me dorëshkrimin duhet ta paraqisni raportin e kontrollit për plagjiaturë. Ngjashmëria duhet të jetë më pak se 20 %. Punimet që nuk shoqërohen me raportin e plagjiaturës do të skanohen brenda sistemit <https://plagiarismcheck.org/> të cilin e ka në dispozicion Fakulteti i Filologjisë.
2. Procesi i vlerësimit i një punimi shkencor fillon në momentin e dorëzimit të punimeve
 - Redaksia e botimit merr dorëshkrimin dhe kryen një shqyrtim fillestar të tij. Nëse në këtë fazë zbulohet një mospërputhje me kërkesat, dorëshkrimi i kthehet autorit.
 - Nëse dorëshkrimi kalon me sukses shqyrtimin fillestar, ai do t'u dërgohet recensentëve për vlerësim (double-blind peer review).
 - Vlerësimi kryhet nga dy recensentë.
 - Vlerësimi pozitiv i recensentëve mundëson vazhdimin e mëtejshëm të procesit të botimit.
 - Nëse recensentët konsiderojnë se punimi mund të botohet pas rishikimit, autorëve u jepet kohë shtesë për rishikimin. Pastaj punimi i rishikuar dërgohet përsëri te recensentët për të marrë vlerësimin përfundimtar.
 - Në rast të një vlerësimi pozitiv dhe një vlerësimi negativ, punimi i dërgohet recensentit të tretë.
 - Nëse punimi ka kaluar me sukses të gjitha fazat e mësipërme, pranohet për botim, dhe redaktorët e botimit e përfshijnë në numrin përkatës të revistës.